



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 23/07/2012
Nr. 0203-812

PËR: Nexhmidin Arifi, Kryetar i Komunës së Vitisë
Skenderbe Hebibi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË E RREGULLORES NR. 01-013/858.

Pranuar, 18.07, 2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, Pas shqyrtimit të Rregullores 01-013/858, për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës Me Fshatrat, Vendbanime dhe Lagjet Urbane, të miratuar me datë 13.04.2012, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik me efekt të plotë juridik si ne vijim;

- Rregullorja 01-013/858, për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës Me Fshatrat, Vendbanime dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Vitisë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 23/07/2012
Br. 0203-812

ZA: Nexhmidin Arifi, Gradonačelnik Opštine Vitina
Skenderbe Hebibi, Predsedavajući Skupštine Opštine Vitina

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI UREDBE BR. 01-013/858.

Prmljena, 18.07, 2012

Poštovani-a

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandator odredjenog po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Vladine Uredbe 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kancelarije Premijera i Ministarstva, Posle razmatranja Uredbe 01-013/858, za Organizovanje i saradnju opštine sa selima, naseljima i urbanim sredinama usvojene dana 13.04.2012, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ocnjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt sa punim pranim efektom, kako sledi ;

- Uredba br 01-013/858, za Organizovanje i saradnju opštine sa selima, naseljima i urbanim sredinama na teritoriji opštine Vitina ;

S poštovanejm,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-e
Direktrima uprava i kancelarija
Arhivi MALS-e.



Republika e Kosovës
Republika Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Data: 17.07.2012			
Nr. i organit Org.broj	Numri/Broj	Shifra e Prilog	Vlera Vendoset
04-013/858			

MINISTRIE SE - MINISTARSTVO
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
GOVERNA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data: 18.07.2012
Date:

Vendosja	Nr. i Lokos	Shifra	Vlera
	0203-812		

0203-812

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika c, si dhe nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 2008/08, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, të nenit 13 pika 13.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, nr. 01-013/491 të dt.21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë më 13.07.2012 miraton këtë :

R R E G U L L O R E

PËR

ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME

FSHATRA, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VITISË.

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, të përcaktuara në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis komunës, fshatrave dhe lagjeve urbane duke formuar këshillat lokale si trupa mbështetës të organeve të komunës, dhe që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimarrjes.

Neni 3

Numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës

1. Për të realizuar sa ma mirë funksionet dhe përgjegjësitë e parapara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Komuna e Vitisë do të mbështesë zgjedhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetarët e këshillave lokale.

2. Numri i këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve formale dhe joformale dhe lagjeve urbane do të paraqiten në listë të veçantë, shtojca nr 1, që do të jetë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
3. Në pamundësi që në çdo fshat dhe lagje urbane të zgjedhen këshillat lokale, atëherë një këshill lokal mund të përfshijë një e më tepër fshatra, apo lagje urbane.

Neni 4

Formimi i komisioneve nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale

1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë 5 anëtarë, prej të cilëve dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës, një anëtar nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe një nga përfaqësuesit e fshatit apo lagjes urbane. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e komisionit.
2. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve të qytetarëve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane.
3. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.
4. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet Zyrës për Informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:
 - 4.1.shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet, ku do të zgjedhen këshillat lokale;
 - 4.2.mediave lokale;
 - 4.3.web – faqes zyrtare të komunës.
5. Njoftimi i publikut domosdo duhet të përmbajë:
 - 5.1 rendin e ditës;
 - 5.2 datën;
 - 5.3 kohën;
 - 5.4 vendin e mbajtjes së tubimit.
6. Pas përfundimit të procesit zgjedhor të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale, komisionet e formuara nga Kuvendet e Komunës pushojnë aktivitetin e tyre.

Neni 5

Formimi i këshillave lokale dhe kriteret e përzgjedhjes

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të ketë prej 7 deri në 11 anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill lokal përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
2. Përbërja e këshillave lokale të fshatit duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor mundësisht duhet të përfshijë minimum 30%. Në rast se në fshat, apo lagje urbane, jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal.
3. Tubimet e qytetarëve i udhëheq një përfaqësues i fshatit i zgjedhur nga shumica e pjesëmarrësve në tubimin zgjedhor.
4. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës zgjedhin anëtarët e këshillit lokal, me rastin e tubimit të qytetarëve, që mbledh të gjithë banorët e interesuar të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
5. Zgjedhja mund të bëhet përmes votimit të hapur apo votimit të fshehtë në tubimin e qytetarëve. Votimi i fshehtë mund të propozohet nga çdo qytetar që merr pjesë në takim nëse përkrahet nga 1/3 e pjesëmarrësve që marrin pjesë në tubim.
6. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë qytetarë të përhershëm në atë lokalitet.
7. Gjatë zgjedhjes së këshillave të fshatrave apo këshillave të lagjeve në qytetin e Vitisë mund të respektohet përfaqësimi proporcional i subjekteve politik, si dhe të gjithë banorëve të fshatit apo qytetarëve të lagjes së qytetit në përbërjen e këtyre këshillave.
8. Për anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, apo lagjeve urbane, zgjedhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
9. Kryetari i këshillit lokal zgjedhet në mes të anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, apo lagjes urbane i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim. Nëse në rrethin e parë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e votave atëherë organizohet rrethi dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për kryetar të këshillit lokal.
10. Anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokale të fshatrave, apo lagjeve urbane, zgjedhen me mandat 4 vjeçar.
11. Së paku një anëtar i komisionit të komunës duhet të jetë prezent në të gjitha tubimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokale.

Neni 6

Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale

1. Në rastet kur qytetarët konsiderojnë që anëtarët ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushë obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtarët dhe kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicë të votave të banorëve të fshatit, apo lagjes urbane me rastin e tubimit publik me qytetarë.
2. Në mënyrë që të bëhet ky votim, kërkohet një peticion për ndërprerjen e mandatit që duhet të nënshkruhet nga banorët e fshatit, apo lagjes urbane. Ky peticion duhet të mbledh nënshkrimet e më shumë se gjysma e numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur këshilli lokal. Komuna duhet të lajmërohet paraprakisht për një mbledhje të tillë.
3. Në rastet kur këshilli lokal shkarkohet sipas procedurave në paragrafin 2, një votim i ri duhet menjëherë të bëhet në bazë të procedurave të nenit 5 të kësaj rregulloreje në mënyrë që të zgjedhet një këshill i ri lokal. Rezultatet e votimit duhet të raportohen në bazë të kërkesave të nenit 6 të kësaj rregulloreje.
4. *Mandati i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon:*
 - 4.1 me kryerje të mandatit;
 - 4.2 nëse vdes;
 - 4.3 nëse jep dorëheqje;
 - 4.4 nëse ndërrohet vendbanim;
 - 4.5 nëse shkarkohet.

Neni 7

Procesverbali nga tubimi zgjedhor

1. Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përshkruajë numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.
2. Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve, për zgjedhjen e këshillave lokale të fshatit, apo lagjes urbane.
3. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve, kryetarit të këshillit lokal duhet të bëhen publike menjëherë pas tubimit zgjedhor.

Neni 8

Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokal

1. Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, dhe lagjeve urbane, që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet e rregullta publike, takimet për planifikim strategjik që organizohen nga komuna, përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.
2. Së paku një anëtar i këshillit lokal të fshatit, apo lagjes urbane duhet të jetë i përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për planifikim të planeve urbane, zhvillimore dhe rurale që janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.
3. Kryetari i Komunës duhet që së paku të organizojë dy takime në vit me udhëheqësit e këshillave lokale. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj. Për rendin e ditës duhet të konsultohen edhe udhëheqësit e këshillave lokale.
4. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal i fshatit, apo lagjes urbane në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

Neni 9

Bartja e aktiviteteve nga komuna te këshillat lokale

1. Me kërkesën e këshillit lokal dhe rekomandimin e Kryetarit të Komunës apo ndonjë komiteti të komunës, Kuvendi i Komunës me vendim mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokale të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane. Aktivitetet që mund të transferohen duhet të jenë në kompetencë ekskluzive vetanake të komunës.
2. Këshilli lokal i fshatit dhe lagjes urbane duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal.
3. Në rast të bartjes së aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal, komuna ofron mbështetje dhe burime të mjaftueshme për fshatrat dhe lagjet urbane me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartur.

Neni 10

Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet në interes të lokalitetit, si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
2. Këshilli lokal i fshatit, apo lagjes urbane, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit, në të gjitha sferat në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale.

3. Këshilli lokal i fshatit, apo lagjes urbane duhet të informojë komunën për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.
4. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, apo lagjes urbane.
5. Këshilli lokal mund të ndërmarë aktivitetet të cilat në veqanti ndikojnë në:
 - 5.1. zhvillimin lokal ekonomik të qëndrueshëm të lokalitetit;
 - 5.2. planifikimin urban dhe rural të lokalitetit;
 - 5.3. mbrojtjen e mjedisit lokal të lokalitetit;
 - 5.4. ndihmon në rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda lokalitetit;
 - 5.5. siguron të dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime, propozime për mbështetje të këtyre rasteve;
 - 5.6. mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave publike të gjelbëruara;
 - 5.7. zhvillimin e turizmit;
 - 5.8. organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
 - 5.9. bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile për çështjet me interes për lokalitetin;
 - 5.10. organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin;
 - 5.11. zbaton aktivitetet që janë të bartura, sipas procedurave në nenin 8 të kësaj rregulloreje.
6. Këshillat lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës përkatëse.
7. Këshillat lokale mund t'i parashtrojnë organeve të kuvendit pyetje me shkrim për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, kurse organet e komunës brenda afatit 30 ditësh i përgjigjen këshillit lokal.

Neni 11

Roli i kryetarëve të këshillave lokale

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, apo lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e komunës.
2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq me mbledhjet e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit lokal. Poashtu, ai i nënshkruan konkluzionet dhe propozimet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditëve, nga dita e miratimit të tyre, t'i dorëzojë te Kryetari i Komunës.

Neni 12
Financimi i aktiviteteve

1. Financimi i aktiviteteve të këshillave lokale mund të bëhet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, nga komuna, nga financimi i përbashkët si dhe nga donatorët në pajtueshmëri të plotë me statutin, rregulloret komunale dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës për menaxhim të financave publike.
2. Këshilli lokal bënë raporte gjashtëmujore dhe vjetore të mjeteve të inkasuara, si dhe atyre të shpenzuara, dhe i bën ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti si dhe para organeve komunale.

Neni 13
Kompenzimi i këshillave lokale

Kompenzimi i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane, përcaktohet nga Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë.

Neni 14
Mospërmbyshja e përgjegjësi

Për të gjitha aktivitetet e hartura në këshillin lokal nga Kuvendi i Komunës, këshilli lokal i fshatit, dhe lagjes urbane përkatëse mban obligime dhe përgjegjësi ligjore.

Neni 15
Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe statutin e komunës mbizotrojnë dispozitat e ligjit dhe statutit.


Neni 16

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njejtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

Neni 17

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, shqyrtimit të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës dhe tetë ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e komunës.
2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, komuna është e obliguar që brenda afatit gjashtë mujor të filloj me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Viti, më 13.07.2012

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Skenderbe Hebib

Lista e fshatërave të komunës së Vitisë

1	Ballancë	
2	Beguncë	
3	Binçë	
4	Budrikë e Epërme	
5	Buzovik	
6	Debelldeh	
7	Devajë	
8	Drobesh	
9	Germovë	
10	Gjylekarë	
11	Goden i Madh	
12	Gushicë	
13	Kabash	
14	Katundi i Ri	
15	Letnicë	
16	Lubishtë	
17	Miak	
18	Podgorc	
19	Pozheran	
20	Qifllak	
21	Radivojcë	
22	Ramjan	
23	Ramnishtë	
24	Remnik	
25	Sadovinë e Çerkezëve	
26	Sadovinë e Jerlive	
27	Shashare	
28	Sllatinë	
29	Smirë	
30	Stubëll e Poshtme	
31	Stublla e Epërme	
32	Tërpezë	
33	Tërstenik	
34	Vërban	
35	Vëmakollë	
36	Vëmez	
37	Viti	
38	Zhiti	